



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 191/5 prot.

Tiranë, më 10.5.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Shkëlqim Miri
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 26.4.2021, është njoftuar vendimi nr. 374, datë 23.4.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Shkëlqim Miri, ish-gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlqim Miri, për shkak të funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar, si dhe në ligjin

nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti, z. Miri, i është nënshtruar procedurës së rivlerësimit bazuar në shortin e hedhur më datë 16.12.2019, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit”. Rezulton se janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar dokumentacion të plotë¹, ndër të tjera, edhe vendimin nr. ***, datë ***.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktimin e masës disiplinore”, ku ka vendosur shkarkimin nga detyra të magjistratit Shkëlqim Miri, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

4. KLGJ, nga provat e administruara, ka konstatuar se magjistrati Shkëlqim Miri, me vendimin nr. ***, datë ***.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë ***.2.2019, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Korrupsionit pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe është dënuar përfundimisht me dy vjet burgim.

5. Në përfundim, KLGJ-ja është shprehur, ndër të tjera, se: ... *Këshilli arrin në përfundimin se, në zbatim të parimit të ligjshmërisë dhe të parimit të mosdënimit pa ligj, rezultoi e provuar se magjistrati Shkëlqim Miri është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi dhe, si rrjedhojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra”, e parashikuar në nenin 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës dhe neni 111, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin ...”.*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 374, datë 23.4.2020, ka vendosur: *“Të deklarojë të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Shkëlqim Miri, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, pasi është dënuar me vendim të formës së prerë”.*

7. Ky vendim është marrë nga Komisioni mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në pikën 2/b të nenit 140 të Kushtetutës, në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 95 të Kodit të Procedurës Administrative.

8. Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të germës “ç”, të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në parashikimet e kësaj dispozite.

¹ Shkresa e KLGJ-së nr. ***/*** prot., datë ***.3.2021, drejtuar Komisionit.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

9. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

10. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre brenda juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

12. Komisioneri Publik konstaton se Komisioni në vendimmarrjen e tij, për raste të ngjashme, duke arsyetuar me të njëjtën bazë ligjore, nenin 140 të Kushtetutës, si dhe nenin 64 pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 96/2016, pika 6, e nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në vendimin nr. 316/2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. *** ***, ka vendosur për *përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit*, ndërsa në vendimin nr. 374/2021, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, ka *vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin, z. Miri, për shkak të humbjes së statusit, pasi është dënuar me vendim të formës së prerë*.

13. Komisioneri Publik ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vendimin nr. 316/2020 të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. *** ***, bazuar në argumentet e parashtruara në atë ankim, si dhe, ndër të tjera, ka kërkuar që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe të orientojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme mbi nevojën për saktësimin e bazës ligjore, arsyetimin ndryshe të vendimit, dhe sipas vlerësimit të Kolegjit, saktësimin e dispozitivit në pikën 1 të tij.

14. Në të tilla rrethana, orientimi që pritet të japë Kolegji, në vendimin e tij përfundimtar për ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 316/2020, eventualisht do të ketë ndikim edhe në shqyrtimin gjyqësor të ankimit konkret të Komisionerit Publik.

IV. Kërkimi i ankimit

15. Në vështrim të sa më sipër, në rrethanat kur Kolegji nuk e ka shprehur ende qëndrimin e tij mbi ankimin e Komisionerit Publik kundrejt vendimit nr. 316/2020, si dhe në rastin kur në momentin e shqyrtimit të ankimit, vendimi i dhënë do jetë në dritën e dhënies së vendimeve orientuese në kuadër të nenit 66, pika 2, të ligjit nr. 84/2016;

16. Nisur nga fakti se standardi i përdorur nga Kolegji është i njëjtë për të gjitha subjektet dhe, bazuar në nenin F/3 të aneksit të Kushtetutës, sipas së cilit: *Juridiksioni kushtetues nuk*

lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetueshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe si i tillë bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

17. Kërkojmë që vendimi nr. 374, datë 23.4.2021, të merret në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë alternative të vendosë:

- Ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 374, datë 23.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,
ose
- Lënien në fuqi të tij.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA